




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.14, datë 30.07.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËRDORIM BURIMI UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE DHE  
TEKNOLOGJIKE”  
SUBJEKTIT “ENI ALBANIA”**



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për “Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjik”e, subjektit “Eni Albania”, me vendndodhje lumi Shkumbin në Fshatin Broshkë Njësia Administrative Papër Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për burimin ujor sipas KRGJSH

- X= 493819.97 ; Y= 4547150.775 ; Z= 55.7 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH

- Nuk ka shkarkime
- Prurja e kërkuar:  $Q= 8.5 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**ALI MYSLIU**

